



## Universiteti i Prizrenit

<b>PROGRAMI MËSIMOR – SYLLABUS</b>							
<b>Niveli i studimeve</b>	katëvjeçar	<b>Programi</b>	<b>Gjuhë dhe letërsi shqipe</b>	<b>Viti akademik</b>	2021/22		
<b>LËNDA</b>		Letërsi krahasimtare					
<b>Viti</b>	III	<b>Statusi i lëndës</b>	Obligative	<b>Kodi</b>		<b>ECTS kredi</b>	<b>5</b>
<b>Semestri</b>	V						
<b>Javët mësimore</b>	15		Orët mësimore			Ligjërata	Ushtrime
						√	√
<b>Metodologjia e mësimit</b>	Ligjërata, ushtrime – ekspikim dhe interpretim i teksteve, seminare, debate, shkrim i eseve etj						
<b>Konsultime</b>							
<b>Mësimdhënësi</b>	Prof.ass.dr.Vjollca Dibra Ibrahim			e-mail	<a href="mailto:vjollca.dibra@uni-prizren.com">vjollca.dibra@uni-prizren.com</a>		
				Tel.	044 199487		
<b>Asistenti</b>	Fikret Ramadani			e-mail			
				Tel.			

<b>Qëllimi studimor i lëndës</b>	<b>Përfitimet e studentit</b>
<p>Moduli i Letërsisë krahasimtare është paraparë që t'i përgatisë studentët e Degës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe për punë hulumtuese – shkencore në një fushë specifike të studimeve letrare. Metodologjia letrare krahasimtare ofron njohuri specifike të metodologjisë letrare, instrumentet dhe nocionet teoriko – letrare siç janë: influencat, interaksionet letrare, relacionet, plagjiarizmi, burimet e letërsisë, gjeneza e zhanreve letrare, intertekstualiteti, përkthimet, receptimi, lexuesi dhe të lexuarit, kontaktet letrare etj. Të gjithë këta konstituentë të Letërsisë krahasimtare do të shtrohen në një proces interaktiv dhe praktik (përmes ligjëratave), ku do të përfshihen shembuj të letërsive të veçanta dhe përfaqësues kryesorë të tyre. Ky modul i konceptualizon nocionet, idetë dhe definicionet siç janë: Letërsi botërore dhe Letërsi nacionale si dhe interaksionet midis tyre, nga njëra anë si dhe vlerat universale letrare të të gjitha kohëve, nga ana tjetër.</p>	<p>Gjatë zhvillimit të ligjëratave, ushtrimeve e konsultimeve si dhe në përfundim të kursit studentët do të kenë mundësinë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Të fitojnë informacione dhe të demonstrojnë njohuri për letërsinë e shkruar në vende të ndryshme e në periudha të ndryshme historiko – letrare;</li> <li>b. Të tregojnë aftësi për lexime kritike si dhe për shkrime kritike – analitike e krahasimtare;</li> <li>c. Të përdorin me saktësi literaturën shkencore teoriko – letrare e historiko – letrare.</li> </ol>

Gjithashtu do të bëhet përpjekje që studentët individualisht apo në grupe të hulumtojnë vetë dukuri, vepra e autorë të letërsisë shqipe e botërore në kontekstin krahasimtar.	
---	--

<b>Metodologjia për realizimin e temave mësimore:</b>			
Ligjërata, ushtrime – ekspikim dhe interpretim i teksteve, seminare, debate, shkrim i eseve etj. Përvç ligjërava, ushtrimeve dhe eseve, do të bëhet edhe interpretimi i veprave nga ana e studentëve, të cilët do t'i lexojnë ato.			
<b>Kushtet për realizimin e temës mësimore:</b>			
Laptop, projektor, prezentim etj.			
<b>Mënyra e vlerësimit të studentit ( në%)</b>			
	<b>Vlerësimi në %</b>	<b>Nota përfundimtare</b>	
- prezantimet studentore, detyrat e shtëpisë – 10 %,	100% - 91%	10 (dhjete)	
-Vlerësimi i parë – 20 %,	90% -81%	9 (nëntë)	
- Vlerësimi i dytë – 15%	80% - 71%	8 (tetë)	
- pjesa me shkrim e provimit final – 50 %,	70% - 61%	7 (shtatë)	
-vijueshmëria, 5%	60% - 51%	6 (gjashtë)	
	50%	5 ( pesë)	
<b>Obligimet e studentit:</b>			
<b>Ligjërata</b> Pjesëmarrja në ligjërata dhe përgatitja e seminareve dhe eseve janë obligative.	<b>Ushtrime</b> <b>Leximi dhe analiza e veprave të autorëve të ndryshëm</b>		
<b>Ngarkesa e studentit për lëndën</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/Javë</b>	<b>Gjithsej:</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Seminare	1	4	4
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	2	4
Kollokfiume, seminare, projektet, prezentimet, etj	1	4	4
Pjesëmarrja aktive ne grupe të vogla	1	15	15

Kontaktet me mësime/ndërkombëtar/konsultimet	1	15	15
Projektet,prezentimet ,etj	2	4	8
<b>Vërejtje: 1 ECTS kredi=25 orë angazhim,p.sh nëse lënda i ka 6 ECTS kredi student duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 150 orë</b>		<b>Ngarkesa totale:</b>	125 orë 125:25= 5 ECTS

Java	Ligjërata		Ushtrime	
1.	Tema	Orët	Tema	Orët
	Letërsia kombëtare, Letërsia botërore dhe Letërsia e përgjithshme	2	Njoftim me lëndën	2
2.	Letërsia e krahasuar – postulatet themelore, bazat teorike dhe historia	2	Demonstrim – lexim dhe komentim i një punimi komparativ	2
3.	Folklori dhe mitologjia	2	Homeri: Iliada – Gj. Fishta: Lahuta e Malcis	2
4.	Letërsia perëndimore deri në Renesancë	2	Eskili: Orestia – Shekspiri: Hamleti	2
5.	Letërsia perëndimore pas Renesancës	2	Dante Aligieri: Komedia hyjnore – Servantesi: Don Kishoti i Mançës	2
6.	Morfologjia letrare (gjinitë, zhanret e format letrare – perspektiva globale)	2	Stendal: E kuqja dhe e zeza – Tolstoj: Ana Karenina	2
7.	Periodizimi ndërkombëtar i letërsisë – periudhat letrare; brezat (gjeneratat)	2	De Rada: Këngët e Milosaos – Pushkini: Eugjen Oniegni;	2
8.	Vleresim i pare	2		2

9.	Idetë letrare (vështrim i përgjithshëm)	2	Homeri: Odiseja - Xh. Xhojs: Uliksi	2
10.	Idetë religjioze dhe idetë filozofike Idetë shkencore dhe idetë politike	2	E Heminguej: Për kë bien kambanat – P. Marko: Hasta la Vista	2
11.	Format artistike; Kufijtë e letrares	2	F. Kafka: Kështjella – Xh. Orvel: 1984	2
12.	Ndërmjetësit letrarë – përkthyesit dhe përkthimet letrare	2	G.A.Burger: Lenore- Konstandini dhe Doruntina: Ismail Kadare-populli	2
13.	Shkëmbimet letrare ndërkombëtare	2	Eskili: Prometheu dhe I.Kadare: Prometeu	2
14.	Vleresim i dyte	2		2
15.	Reminishencat, huazimet letrare dhe ndikimet	2	Miti i Narçizit dhe Pasqyrat e Narçizit: Ernest Koliqi	2

#### LITERATURA

Homeri: Iliada – Gj. Fishta: Lahuta e Malcis; Eskili: Orestia – Shekspiri: Hamleti; Dante Aligieri: Komedia hyjnore – Servantesi: Don Kishoti i Mançës; Stendal: E kuqja dhe e zeza – Tolstoj: Ana Karenina; De Rada: Këngët e Milosaos – Pushkini: Eugjen Oniegin; Homer: Odiseja - Xh. Xhojs: Uliksi; E Heminguej: Për kë bien kambanat – P. Marko: Hasta la Vista; F. Kafka: Kështjella – Xh. Orvel: 1984

Literatura shtesë:

Yves Chevrel: Letërsi e krahasuar, Tiranë 2002; Rene Velek e Ostin Uoren: Teoria e letërsisë, Vjollca Dibra: Heroinat e deheroizuara, (Vështrim komparativ) Tiranë 2011; Northrop Fraj: Anatomia e kritikës; Osman Gashi: Miti dhe romantizmi evropian, Prishtinë 2005; Kufijtë e letërsisë, Prishtinë, 2008; Eliot, Thomas Sterns: Ese të zgjedhura, Prishtinë, 1982; Croce, Benedetto: Poezia antike dhe moderne, Tiranë, 1998; Claudio Guillen: “The Challenge of Comparative literature”, Harvard University Press, 1993;

#### VËREJTJE

Nuk do të ketë kurrfarë tolerime për “huazim” nga interneti apo kudo tjetër. Punimet e njejta apo të ngjajshme gjithashtu do të ndëshkohen. Rekomandohet që punimet që dorëzohen të jenë të shkruara me kompjuter.

**Vërejtje për studentin:**

Studentët duhet t’u përbahen rregullave të përcaktuara sipas Statutit të UPZ-së dhe rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Senati i UPZ-së dhe këshilli mësimor